

VENDIM
Nr. 93, datë 16.7.2012

PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLAT E TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

(ndryshuar me vendimin nr. 179, datë 28.12.2012)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 9 dhe 54 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 26 të "Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s", miratuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.7.2012, pasi shqyrtoi propozimin e drejtorive teknike për disa ndryshime në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike (ndryshimet sipas tekstit bashkëlidhur).

2. *Ky vendim do t'i shtrijë efektet deri në 31 janar 2013.*

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

NDRYSHIMET NË RREGULLAT E TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

A) Në kapitullin IX pika 1.3 bëhen këto ndryshime:

IX.1.3 a) Çmimi i energjisë balancuese llogaritet për çdo muaj me çmimin maksimal të blerjes të energjisë elektrike në tregun e parregulluar nga KESH sh.a., plus 10% të këtij çmimi ose në mungesë të tij me çmimin e blerjes së energjisë elektrike nga FPSH-ja prej prodhuesve të vegjël, heceve të reja koncesionare, miratuar nga ERE, plus 20 % të këtij çmimi, për disbalancat negative.

IX.1.3 b) OST sh.a. çdo ditë do të bëjë shumën aritmetike të 24 orëve të disbalancave negative të shkaktuara nga çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike dhe çdo muaj do të përgatisë faturën mujore si shumë aritmetike e çdo 24 orëve të disbalancave negative dhe do t'i dërgojë pjesëmarrësve të tregut faturat përkatëse.

OST sh.a. do të bëjë shumën aritmetike të 24 orëve të disbalancave pozitive të shkaktuara nga çdo pjesëmarrës tregu i energjisë elektrike dhe çdo muaj do të përgatisë faturën mujore si shumë aritmetike e çdo 24 orëve të disbalancave pozitive, të cilat do të jenë me çmimin e gjenerimit publik dhe do t'i dërgojë pjesëmarrësve të tregut faturat përkatëse. OST/Operatori i Tregut njofton pjesëmarrësit e tregut për disbalancat e tyre për ditën paraardhëse brenda orës 12:00 të ditës pasardhëse.

IX.1.3 c) *Gjeneruesit e energjisë elektrike do të jenë objekt i disbalancave sipas dispozitës së mësipërme.*

Për gjeneruesit që janë të lidhur në rrjetin e shpërndarjes, disbalancat do të llogariten me matje (aparaturë matëse).

Për gjeneruesit që janë të lidhur në rrjetin e transmetimit, disbalancat do të llogariten me matje duke filluar që nga data 1 shkurt 2013.

KESH (Gen), në cilësinë e siguruesit të balancimit, nuk është subjekt i trajtimit të disbalancave, duke filluar nga data 1 gusht 2012.

FPSH referuar Modelit të Tregut, pika 6, nuk do të jetë subjekt i trajtimit të disbalancave, duke filluar nga data 1 gusht 2012

IX.1.3 d) Brenda datës 5 të muajit n+1, KESH-i i dërgon OST-së çmimin e importeve të

energjisë elektrike, të realizuar prej tij, për muajin n. OST sh.a., brenda datës 10 të muajit n+1, u dërgon faturat pjesëmarrësve të tregut. Në llogaritjen e pagesave OST sh.a. do të përdorë kursin mesatar të këmbimit të euro/lekë të muajit n të publikuar nga Banka e Shqipërisë.

HEC-et e vegjël të lidhur në rrjetin e shpërndarjes nuk do të jenë subjekt i trajtimit nga disbalancat deri më 31 qershor 2013.

IX.1.3 e) Disbalancat brenda kufirit +/- 5% do të kompensohen në natyrë në bazë, në javën pas operimit.

B) Në shtojcën A “Terma dhe përkufizime” paragrafi 2, termi “disbalanca” ndryshon dhe bëhet:

Disbalanca është diferenca midis fluksit të energjisë të përcaktuar nga një kontratë dypalëshe (p.sh. nominimi fizik i programit) dhe fluksit aktual të matur të energjisë, për një orë të caktuar.

Një gjenerator është në balancë kur gjenerimi i tij i matur është i barabartë me sasinë e programuar, livrimin e tij të kontraktuar, në një orë të caktuar.

Një furnizues (i kualifikuar/klient i kualifikuar/OSSH) është në balancë, kur konsumi i tij i matur përputhet me kërkesën e tij të kontraktuar.

Një gjenerator është *në disbalancë negative*, kur gjenerimi i tij i matur është më i vogël se livrimi i tij i kontraktuar.

Një furnizues (i kualifikuar/klient i kualifikuar/OSSH) është *në disbalancë negative*, kur konsumi i tij i matur është më i madh se kërkesa e tij e kontraktuar.

Një gjenerator është *në disbalancë pozitive* kur gjenerimi i tij i matur është më i madh se livrimi i tij i kontraktuar.

Një furnizues (i kualifikuar/klient i kualifikuar/OSSH) është *në disbalancë pozitive* kur konsumi i tij i matur është më i vogël se kërkesa e tij e kontraktuar.

Këto ndryshime hyjnë në fuqi në datën 1 gusht 2012 dhe do të shtrijnë efektet deri në fund të vitit 2012.